



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 44

Datë: 24. 10. 2020. Ora: 10:30.

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burmi Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

2. Aktivitetet e ZRPPC-së:

-Vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar Komune në Mitrovicën Veriore

-Vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar Komune në Podujevë.

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Kemi kuorum ! E fillojmë mbledhjen... A ka ndokush vërejtje, ëkrkesë...?

Sami Kurteshi: Po, e kam një cështje për diskutim, dhe nëse doni e fusim s'i pikë të rendit të ditës, ose e lëmë në të dryshme...! Ka të bëjë me faktin, nëse ndonjë person është i izoluar nga kovid, në rastin ekstrem ndonjëri prej kandidatëve, s'i do veproji KQZ ?

Valdete Daka: Këta persona, hyjnë te ata të ngjuar, mirëpo këta vetëm duhet të jenë të regjistruar. S'ka ndonjë mënyrë tjetër. Mendoj që, ta diskutojmë në të ndryshme.

2. Aktivitetet e ZRPPC-së:

1.Vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar Komune në Mitrovicën Veriore:

Yll Buleshkaj: Falemnderit. Zyra, ashtu sic është praktike, në rrjedhën e procesve zgjedhore rekomandon për kufizimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore për subjektet politike. Ne kemi pranuar numrin e votuesve nga komuna e Mitrovisës veriore. Pra, kemi 23 180 votues të regjistruar. Shpenzimet, sipas rregullës zgjedhore, subjektet politike në garë për secilin votues lejohet të shpenzojnë 50 cent, që kufiri i sipër i sipërm i shpenzimeve për fushatë, është 11 590 euro.

Ne, rekomandojmë për aprovim.

Valdete Daka: A ka pyetje ?

Alim Rama: Pse është dashur me u thirrë me urgjencë kjo mbledhje, kur asnjë subjekt politik ende nuk është certifikuar ?

Valdete Daka: Për shkak të afatit ligjor që, janë të bazuar mbi planin operacional.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë vendim të shpenzimeve

2.Vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar Komune në Podujevë:

Yll Buleshkaj: Ne, kemi pasur një vendim që është nxjerrë më 11 shkurt 2020, mirëpo për shkak të vendimit të KQZ që votuesit nga kjo kohë që i kanë mbushur 18 vjet, të përfshihen në listën votuese. Pra, sipas kësaj liste votuese të re, ndryshon edhe kufiri i shpenzimeve. Pra, sipas listës së pranuar, i kemi 87 863 votues të regjistruar që kanë të drejtë votimi. Kurse, kufiri i sipërm i shpenzimeve që ka qenë 43 433 euro, dhe është ngritur për rreth 600 euro, që domethënë është: 43 931.50 euro.

Valdete Daka: Në total, shpenzimet janë 43 931.50 euro.

Eshref Vishi: Sa është shtuar numri i votuesve të rinjë ?

Yll Buleshkaj: Më pak se 1200 votues.

Valdete Daka: Kush është për këtë rekomandim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë vendim të shpenzimeve

3.Të ndryshme !

Valdete Daka: Ju njoftoj se është përgatitur shkresa për IKSHP-në se, çfarë procedura shtesë mund të kemi, apo është vetëm manuali që tashmë, e kemi nga e kaluara. Pra, të shohim se a do të kemi procedura shtesë... Pastaj, do të doja të njoftohemi gjatë ditëve në vijim se s'i do të votojnë dhe në cilën kategori, do të hyjnë personat që eventualisht, do të jenë me covid... Sekretariati, të na përgatis njoftimin lidhur me këtë çështje...

Në këtë pikë, diskutuan, analizuan dhe shprehen idetë dhe mendimet e tyre rreth kësaj çështje, edhe: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Valdete Daka dhe Burim Ahmetaj (kryeshef).